



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 752 Akti

Nr. 764 Vendimi
Tiranë, më 17.5.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 17.5.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Klemend Kajana**, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z. Klemend Kajana është subjekt rivlerësimi referuar pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi nga data 9.6.2015 deri aktualisht si dhe në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Klemend Kajana i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2021, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo) dhe Xhensila Pine (relatore).

iii. Nga Komisioni janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Shkolla e Magjistraturës.

iv. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisionerin Roland Ilia dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Me vendimin datë 4.4.2024 të trupit gjykues është administruar dosja e bashkëshortes së subjektit, ish-subjekt rivlerësimi, znj. M.K, e cila, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është hetuar nga Komisioni.

vi. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se: *“Konfirmoj dakordësinë me deklaratimet e bashkëshortes sime dhe provat e dorëzuara prej saj në përgjigje të pyetësorëve, dërguar nga Komisioni për kriterin e pasurisë”*.

vii. Subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana është emëruar në datën 9.6.2015 si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe është martuar me bashkëshorten në datën 18.7.2008, sipas aktit nr. *** të Zyrës së Gjendjes Civile. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitet 2008 – 2016, në cilësinë e personit të lidhur bashkëshorten e tij M.K .

viii. Trupi gjykues me vendimin nr. 2, datë 9.5.2024, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Klemend Kajana, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me rezultatet e hetimit kryesisht referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

ix. Në datën 9.5.2024, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri më datë 15.5.2024.

x. Trupi gjykues, pas marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Klemend Kajana në seancë dëgjimore, në datën 17.5.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

xi. Në datën 17.5.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

III. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

1. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese për subjektin e rivlerësimit Klemend Kajana ka arritur në konkluzionin se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti ka dorëzuar vetëm deklaratën *Vetting*.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

3. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana, si dhe të personave të lidhur me të.

4. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana u krye bazuar në: (a) shqyrtimin e të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 27.1.2017, për subjektin e rivlerësimit; (b) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (c) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet e/të administruara në dosjen e bashkëshortes së tij, si dhe nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarinimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ, duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron kryerjen e procesit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana. Nga ky hetim ka rezultuar si vijon:

5. Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 110.11 m², ndodhur në Y, Tiranë, blerë në vitin 2013, nga shoqëria “****” sh.p.k., në emër të shtetasve Klemend dhe M.K . Vlera: 41.300 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimi të deklaruar: kursimet e realizuara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij në vite dhe pjesërisht me kredi nga BKT-ja.

6. Në momentin e deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur në ILDKPKI:

- kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme me kusht kreditimi nga banka nr. ***, datë 29.4.2013.
- certifikatë për vërtetim pronësie nr.***, datë 2.3.2011, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., shoqëruar me kartelën e pasurisë nr. ***, hartën treguese të regjistrimit;
- mandat depozitimi për të tretë nga subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana në “Raiffeisen Bank”, datë 29.4.2013, shuma 4.310 euro, derdh 10% për ngrirje paradhënieje të kontratës nr. ***, datë 29.4.2013, dhe planimetri të apartamentit ***/kati dytë;
- urdhër pagese, transferim fondesh i brendshëm, i bankës Credit Agricole Shqipëri, dega Fier, i shumës 18.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana tek shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrim pagese (kësti nr. ***) për blerje apartamenti (nr. ***/kati i dytë), i datës 17.6.2013;
- mandatarkëtimi i Credit Agricole Shqipëri, dega Fier, i shumës 18.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana tek shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “Depozitë në për blerje apartamenti” dhe konfirmim numër llogarie i datës 14.6.2013 nga shoqëria “ ****” sh.p.k.;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., pjesë përbërëse e kontratës nr. ***, datë 29.4.2013, në të cilën shoqëria “****” sh.p.k. konfirmon shlyerje totale të apartamentit nga pala blerëse Klemend dhe M.K ;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 19.8.2014, për pasurinë apartament me sip. 97.8 m², shoqëruar nga kartela e pasurisë;
- *statement* datë 20.6.2013, ku pasqyrohet kalimi i shumës 18.000 euro nga subjekti i rivlerësimit tek shoqëria “****” sh.p.k.;
- kontratë kredie bankare nr. ***, datë 25.4.2013, aneks i çeljes dhe përdorimit të kredisë datë 25.6.2013;
- ndryshime në kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 13.3.2014 dhe vërtetim nr. *** prot., datë 18.1.2017, nga BKT-ja për çeljen e kredisë në datën 17.3.2014, në shumën totale 2.500.000 lekë.

7. Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

7.1 ZRPP-ja konfirmon se subjekti Klemend Kajana ka në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij pasurinë vol. ***, f. ***, z. k. ***, apartament me sip. 97.8 m², Tiranë.

7.2 Me kontratën e shitjes me kusht kreditimi nga banka nr. *** datë 29.4.2013, rezulton se shoqëria “*** ” sh.p.k. i ka shitur subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes të tij pasurinë në vlerën 43.100 euro.

7.3 Sipas kontratës së shitjes me kusht, çmimi i blerjes së apartamentit është 43.100 euro, parashikuar për t’u paguar përkatësisht: (i) kësti i parë në shumën 4.310 euro, shumë që përbën 10% të çmimit kontraktor, e cila do të paguhet në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate në llogarinë e hapur të noteres, në Raiffeisen Bank; (ii) kësti i dytë në shumën 17.420 euro që përbën 40% të çmimit të përgjithshëm, vlerë e cila do të paguhet pas miratimit të kredisë, konkretisht në datën e disbursimit të saj, në llogarinë bankare të palës shitëse të hapur pranë Alpha Bank; (iii) kësti i tretë i çmimit kontraktor 21.550 euro do të paguhet përmes një kredie bankare të miratuar dhe disbursuar nga Banka Kombëtare Tregtare, dega Fier.

7.4 Me kartelën e pasurisë, provë e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se kjo pasuri është blerë në shumën 43.100 euro. Po sipas kësaj karte, pasuria ka qenë e hipotekuar në favor të Bankës Kombëtare Tregtare për shumën 2.900.000 lekë, sipas kontratës së hipotekimit nr. *** dhe më tej është liruar sipas deklaratës noteriale nr. *** dhe pikës 7 të kontratës së shitjes me kusht.

7.5 Komisioni, pasi administroi praktikën e bashkëshortes së subjektit, konstatoi se në pyetësorin e datës 28.3.2019, kjo e fundit është pyetur në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacionin justifikues lidhur me pagesat e kryera. Në përgjigjen e dhënë, bashkëshortja e subjektit ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues.

7.6 Sipas akteve të depozituara ka rezultuar se në datën 29.4.2013, në Raiffeisen Bank është kryer pagesa për këstin e parë në masën 10% të çmimit të apartamentit, shumë kjo e depozituar në llogarinë e noteres sipas kontratës së shitjes; në datën 17.6.2013, në bankën Credit Agricole në llogarinë e shoqërisë “*** ” sh.p.k., me titull pagesë kësti nr. ***, është derdhur shuma 18.000 euro; në datën 17.3.2014 është bërë kalimi i shumës 2.461.150 lekë (nga shuma e përfituar 2.500.000 lekë), kredi e përfituar nga BKT-ja, e kaluar në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k., në datën 17.3.2014; si dhe në vijim janë derdhur shumat përkatëse në datat 5.8.2013, 10.6.2014, 25.6.2014, 16.7.2014 dhe 16.7.2014, që në tërësi pagesat konfirmojnë shumën 43.100 euro për shlyerjen e kësaj pasurie.

7.7 Sipas deklaratës noteriale datë 16.7.2014, përfaqësuesi i shoqërisë “*** ” sh.p.k., me cilësinë e shitësit të kësaj pasurie ka deklaruar se ka marrë në dorëzim në masë të plotë dhe pa diferenca çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes me kusht.

Analiza e burimeve të krijimit të pasurisë

8. Kredia bankare e përdorur si burimi krijimi

8.1 Komisioni lidhur me këtë kredi me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2021, i ka kërkuar informacion BKT-së.

8.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2021, BKT-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë bashkëkredimarrës në shumën 2.500.000 lekë. Banka ka vënë në dispozicion praktikën përkatëse lidhur me këtë kredimarrje.

8.3 Nga praktika e kredisë rezulton se me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.6.2013, nënshkruar midis BKT-së, dega Fier, dhe bashkëkredimarrësve, subjektit të rivlerësimit i është parashikuar përfitimi në shumën 2.900.000 lekë, bazuar në ligjin nr. 9232/2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar.

8.4 Kontrata e mësipërme e kredisë bankare është ndryshuar me aneksin e kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.3.2014, nënshkruar midis palëve sipas së cilës rezulton se palët kanë pranuar ndryshimet përkatëse duke përfituar kredinë me norma të zakonshme interesi.

8.5 Me kontratën e hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.6.2013, është vendosur kolateral apartamenti me sip. 97.8 m², me nr. pasurie ***, Y, Tiranë. Kredia rezulton e disbursuar në datën 17.3.2014.

8.6 Nisur nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna nga bashkëshortja e subjektit në dosjen e saj të hetimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk konstatohen problematika lidhur me përfitimin e kredisë nga subjekti i rivlerësimit.

8.7 Në këtë konkluzion u mbajt në konsideratë edhe sa Kolegji në vendimin nr. 15, datë 10.7.2020, ka arsyetuar lidhur me kushtet e përfitimit të kësaj kredie se *subjekti i rivlerësimit M.K nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, sikurse edhe Komisioneri në pretendimet përfundimtare parashtroi se nuk rezultonte që prokurorja M.K të kishte kryer ndonjë veprim procedural në lidhje me hetimin e zyrtarëve të Bashkisë Fier, si dhe nuk kishte mbajtur detyrën e prokurorit drejtues/më të lartë, teksa bashkëshorti i saj listohet për të përfituar nga kjo bashki një kredi me kushte lehtësuese për familjet e pastreha.*

9. Në lidhje me kursimet familjare nga të ardhurat

9.1 Komisioni analizoi mundësinë financiare për blerjen e pasurisë, duke përllogaritur kursimet e krijuara nga të ardhurat nga pagat e subjektit, babait dhe bashkëshortes të tij, dhe referuar arsyetimit në vendimin nr. 15, datë 10.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm i Apelit, i cili lidhur me të ardhurat familjare të përdorura si burim krijimi për këtë pasuri ka vlerësuar se:

“Gjithashtu, në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të z. Klemend Kajana nga punësimi, në vijim të pretendimit të Komisionerit Publik në ankimin e datës 2.8.2019, në paragrafin 18.1.7, në faqen 15 të tij: këto të ardhura nuk duhet të llogariteshin nga ana e Komisionit si burime të ligjshme të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, znj. M.K, dhe bashkëshortit të saj, Kolegji kreu analizën financiare për vitet 2013 dhe 2014, vite kur personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka përfituar të ardhurat nga punësimi.

Në përfundim, në përgjigje të pretendimit të Komisionerit në ankim, në paragrafin 18.1.7, në faqen 15 të tij, nga analiza e kryer në Kolegj rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. M.K, mbulonte me burime të ligjshme nga të ardhura të dokumentuara pasuritë, shpenzimet dhe likuiditetet e krijuara në vitet 2013 dhe 2014, edhe duke mos i konsideruar të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga punësimi”.

9.2 Komisioni, pasi kreu analizën financiare për subjektin dhe personat e lidhur për burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë, duke përllogaritur të ardhurat, si dhe shpenzimet e kryera, në referim edhe të sa më sipër arsyetuar, në vendimin nr. 15, datë 10.7.2020, të Kolegjit, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana dhe personat e lidhur me të mbulojnë me burime të ligjshme nga të ardhura të dokumentuara pasuritë, shpenzimet dhe likuiditetet e krijuara në vitet 2013 dhe 2014, edhe duke mos i konsideruar të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga punësimi në vitet 2013 – 2014.

10. Lidhur me apartamentin me sip. 41.9 m², të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave

10.1 Ky apartament me nr. ***, shkalla ***, kati i dytë, ndodhur në Lagjen Nr. ***, ***, Durrës, në qershor të vitit 2012, në bashkëpronësi me bashkëshorten M.K dhe babain Th.K, në pjesë të barabarta (subjekti ka deklaruar: *“Blerë me të ardhura të kursyera ndër vite nga pagat e mia, bashkëshortes dhe babait Th.K ”*); shitur në muajin dhjetor 2012. Vlera e apartamentit: 473.497 lekë. Pjesa takuese: 33.33%.

11. Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

11.1 Në DVP-në e vitit 2012 është deklaruar: *“Apartament në Lagjen Nr. ***, Durrës, me sipërfaqe 49.1 m², datë 30.6.2012, nga EKB-ja, si privatizim në emër të Th.K, Klemend Kajana, M.K , në pjesë të barabarta, në shumën 473.497 lekë, me burim krijimi: kursimet e pagës së saj dhe bashkëshortit”.*

11.2 Në momentin e deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur në ILDKPKI kontratën e shitjes përfundimtare nr. ***, datë 30.6.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palëve blerëse Th.K, Klemend Kajana, M.K , të një apartamenti me sip. 41.9 m², në shumën 473.497 lekë, me vendndodhje në Durrës.

11.3 Sa më sipër dukej se kishte mospërputhje mes deklaramit të bërë në deklaratën *Vetting* se për burimin e kësaj pasurie janë përdorur edhe kursimet ndër vite të babait të subjektit me deklaramin e bërë në deklaratën periodike për vitin 2012 se për burimin e kësaj pasurie janë përdorur kursimet e pagës së subjektit dhe bashkëshortes së tij.

11.4 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 për të paraqitur shpjegime lidhur me mospërputhjet e mësipërme.

11.5 Në shpjegime, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Ky është një lapsus i bërë nga ana jonë në deklaratën periodike për vitin 2012, pasi deklarami i saktë është ai i bërë në deklaratën për efekt Vetting-u. Ndodhur në këto kushte, referuar edhe mandatpagesës pranë Credins Bank për pagesën e bërë për EKB-në, e deklaruar edhe në pjesën e deklaramit të kryer prej tij si person i lidhur yni, kontributi i tij është evident.*

Për këtë arsye unë kam saktësuar në deklaratën Vetting dhe saktësoj në këto shpjegime se burimi i krijimit të kësaj pasurie është me të ardhura nga paga e babait si mësuës, paga e bashkëshortes dhe paga ime, duke qenë se për një kohë të gjatë jetesa jonë dhe rrjedhimisht ekonomia jonë ka qenë dhe është e përbashkët”.

11.6 Për vërtetimin e deklaramive të subjektit të rivlerësimit është administruar dokumentacioni ligjor provues. Nga aktet e administruara rezulton se kjo pasuri është blerë me kontratën e shitjes përfundimtare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2012, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe shtetasve Th.K , Klemend Kajana dhe M.K .

11.7 Nga dokumentacioni rezulton se privatizimi është kryer me Entin Kombëtar të Banesave sipas përbërjes familjare në muajin mars për vitin 2011, ku pjesë përbërëse janë Th.K , babai i subjektit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij dhe djali i mitur i subjektit.

11.8 Trupi gjyqës, pas shpjegimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në shpjegimet e tij dhe se mospërputhja e konstatuar lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke krahasuar deklaratën e vitit 2012 me deklaratën *Vetting*.

11.9 Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me aftësinë paguese të kësaj pasurie, duke përlllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2012 deri në momentin e blerjes së pasurisë, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

12. Lidhur me shitjen e kësaj pasurie

12.1 Në deklaratën për vitin 2012, depozituar në dosjen e ILDKPKI-së, është deklaruar shitja e kësaj pasurie, si dhe të ardhurat në shumën 1.700.000 lekë të përfituara prej saj.

12.2 Në momentin e deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur në ILDKPKI kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.12.2012, nënshkruar ndërmjet palëve shitëse Th, Klemend dhe M.K dhe palës blerëse N.H , të apartamentit me sip. 41.9 m², regjistruar me nr. ***, në vlerën 1.700.000 lekë.

12.3 Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 6.12.2012, kjo pasuri i është shitur shtetasës N.H në vlerën 1.700.000 lekë. Rezulton se pagesa është kryer me transfertë bankare në datën

6.12.2012, në shumën 1.700.000 lekë, nga blerësja e kësaj pasurie në Societe Generale Bank për subjektin e rivlerësimit Klemend Kajana.

12.4 Bashkëshortja e subjektit, e pyetur gjatë periudhës së hetimit të saj në lidhje me përdorimin e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie, ka dhënë shpjegime se paratë janë përdorur kryesisht për arredimin e shtëpisë. Rezulton se ky deklaram mbështetet nga deklaramet e subjektit të rivlerësimit, i cili ka deklaruar shpenzime për arredim në DVP-në e vitit 2013, në shumën 1.400.000 lekë.

13. Lidhur me automjetin tip “**”**

13.1 Ky automjet është regjistruar në emër të znj. M.K (bashkëshortja e subjektit), blerë më 22.10.2016. Burimi i krijimit: kursimet nga pagat dhe nga shitja e automjetit tip “****”. Vlera e automjetit: 450.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

14. Në momentin e deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur në ILDKPKI kontratë shitjeje pasurie të luajtshme nr. ***, datë 22.10.2016, nënshkruar ndërmjet palës shitëse E.K dhe palës blerëse M.K të automjetit tip “****”, në vlerën 450.000 lekë, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

14.1 DPSHTRR-ja konfirmon se bashkëshortja e subjektit ka në pronësi mjetin me targë AA *** MD, të regjistruar në DPSHTRR Durrës, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., datë 22.10.2016, në vlerën 450.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

14.2 Po nga aktet e administruara rezulton se me kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.2015, ndërmjet shitësit, subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana dhe blerësit B.D , është shitur automjeti tip “****”, në vlerën 2.500 euro.

14.3 Të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie të luajtshme janë deklaruar nga subjekti dhe nga bashkëshortja gjendje *cash* në vitin 2015, të cilat janë deklaruar në vijim se janë përdorur për blerjen e automjetit tip “****” në vitin pasardhës.

14.4 Trupi gjykues, pas hetimit të kryer dhe rezultateve nga analiza financiare, arriti në konkluzionin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e pasurisë së luajtshme **automjet tip “****”** më 22.10.2016.

15. Lidhur me blerje obligacionesh të thesarit në Bankën e Shqipërisë

15.1 Subjekti dhe bashkëshortja kanë investuar në blerjen e obligacioneve të thesarit në Bankën e Shqipërisë nga Raiffeisen Bank, në emër të znj. M.K , në bashkëpronësi me bashkëshortin, në vitin 2015. Burimi i krijimit: kursime nga pagat ndër vite. Vlera: 1.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

15.2 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2021, konfirmon investimin në obligacion nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në shumën 1.500.000 lekë. Me vërtetimin mbi shpalljen fitues nga Raiffeisen Bank, provohet investimi për vlerën 1.500.000 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit, në ankandin nr. ***, për blerje obligacionesh të thesarit, data e emetimit 5.10.2015.

15.3 Blerja e letrave me vlerë në formën e obligacioneve të thesarit nga data e krijimit deri në datën e deklaramit u analizua nga ana e Komisionit në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, nga e cila provohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e obligacioneve të thesarit, në vitin 2015, në vlerën 1.500.000 lekë në Bankën e Shqipërisë.

16. Lidhur me pasuritë e luajtshme si vijon:

- Gjendje llogarie rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, më 20.1.2017, në emër të znj. M.K . Shuma: 608.825,82 lekë.
- Gjendje llogarie rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, më 20.1.2017, në emër të subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana, në shumën 68.939,29 lekë.
- Gjendje në depozitë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana, në Credins Bank, në shumën 1.666,25 euro.
- Detyrim i përbashkët kredie ndaj Bankës Kombëtare Tregtare.
- Marrëveshje mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit *MasterCard*, me Raiffeisen Bank në emër të znj. M.K , lidhur më 17.3.2015 për shumën 1.000 euro.
- Kontratë kredie me kufi (*overdraft*) me Raiffeisen Bank, në emër të znj. M.K (bashkëshortja e subjektit), më 29.9.2015, për shumën 100.000 lekë.
- Marrëveshje mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit *MasterCard* me Raiffeisen Bank në emër të z. Klemend Kajana, lidhur më 23.9.2011 për shumën 1.500 euro.

16.1 Pas hetimit të kryer, trupi gjykues, nuk konstatoi problematika për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur sa i përket këtyre llogarive bankare dhe nga hetimi i kryer arriti në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme për deklaratimet e gjendjeve të mësipërme në llogaritë bankare.

Deklarimi i pasurive të babait të subjektit të rivlerësimit

17. Pasuria arë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 1.470 m², në ***. Burimi i krijimit: trashëgimia e babait N.K . Certifikata e pronësisë lëshuar më 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

18. Pasuria arë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 5350 m², në ***. Burimi i krijimit: trashëgimia e babait N.K . Certifikata e pronësisë lëshuar më 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

19. Pasuria arë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 3.060 m², në ***. Burimi i krijimit: trashëgimia e babait N.K . Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

20. Pasuria arë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 840 m², në ***. Burimi i krijimit: trashëgimia e babait N.K . Certifikata e pronësisë lëshuar më 28.7.2005. Bashkëpronësi sipas listës.

21. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Vlera: 40.000 lekë.

Trupi gjykues, pas hetimit të kryer lidhur me pasuri të babait të subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se nuk konstatohen problematika lidhur me këto pasiuri të luajtshme e të paluajtshme të babait të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

22. Komisioni në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklaratim të rremë; si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

23. Komisioni, pas hetimit të kryer bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

24. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

25. AKSIK-ja ka paraqitur pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana, i deklasifikuar plotësisht, nga ku rezulton: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë e në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që vetë ai ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana.

26. Komisioni nga hetimi i kryer nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e figurës

27. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

28. Komisioni lidhur me kriterin e figurës nuk konstatoi *indicie* apo informacione sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

29. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

30. Vlerësimi i aftësive profesionale i ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

31. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Klemend Kajana është hartuar nga KLGJ-ja, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e në vijim të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në përshkrimin dhe analizimin e 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së, si dhe rezultateve të testimiit pranë Shkollës së Magjistraturës. Nga ky raport nuk u konstatuan problematika lidhur me subjektin e rivlerësimit.

32. Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë pranë Komisionit rezultatet e testimiit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, parashikuar në pikën 4 të nenit 179/b të

Kushtetutës dhe pikën 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

33. Nga verifikimi i regjistrit të denoncimeve nuk rezulton të jenë depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit denoncime për subjektin e rivlerësimit Klemend Kajana, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e aftësive profesionale

34. Trupi gjykues bazuar në: (i) gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor; (ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e në vijim të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (iii) dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ – arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Klemend Kajana:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Klemend Kajana, ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.5.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku